



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

INFORMACION MBI TREGUN

TELEFONIA CELULAR

ALBTELECOM

2003-2008

Tabela e Pembajtjes

I. HYRJE	3
II. NUMRI I PERDORUESVE TE TELEFONISE CELULARE DHE FIKSE	3
II.2 STRUKTURA E PERDORUESVE TE OPERATOREVE TE TELEFONISE FIKSE DHE MOBILE.....	5
III. PERDORIMI I SHERBIMEVE TELEFONIKE CELULARE.....	8
III.1 Trafiku telefonik dhe SMS.....	8
III.2 Pjeset e tregut te Operatoreve celulare.....	10
III.3. Perdorimi mesatar per perdorues i sherbimeve celulare	11
III. PERDORIMI I SHERBIMEVE TELEFONIKE TE ALBTELECOM	14
IV.1 Trafiku telefonik i Albtelecom	14
IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom	16

Liste e Figurave dhe Tabelave

Figure .1 Perdoruesit e telefonise Mobile sipas operatoreve per 2003-2008	3
Fig.2 Perdoruesit e telefonise fiks per Albtelekom dhe Op. Alternative 2003-2008	4
Fig.3 Perdorues te telefonise Mobile dhe Fiks 2003 - 2008	5
Fig.4 Penetrimi i telefonise Mobile dhe Fiks 2003 - 2008	5
Fig.5 Perdoruesit sipas struktura te Albtelecom per 2003-2008	6
Fig.6 Ecuria e numrit te perdoruesve dhe struktura e tyre 2003-2008	7
Fig.7 Perdoruesit me kontrate ne raport me totalin e perdoruesve 2003-2008.....	7
Fig.8 Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2003-2008	8
Fig.9 Trafiku hyres celular sipas origjines 2003-2008	9
Fig.10 Numri i SMS-ve sipas operatoreve mobile ne 2003-2008	9
Tabela 1. Pjesset e tregut 2008.....	10
Tabela 2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare 2003-2008.....	11
Fig.11 Thirrje dalese per perdorues te Vodafone 2003-2008.....	12
Fig.12 Thirrje dalese per perdorues te AMC 2003-2008.....	12
Tabela 3. Kohezgjatja mesatare e thirrjeve celulare	13
Fig.13 Trafiku dales i Albtelecom per 2003-2008.....	14
Fig.14 Trafiku dales kombetar i Albtelecom per 2003-2008.....	15
Fig.14 Trafiku hyres i Albtelecom sipas origjines per 2003-2008.....	15
Fig.15 Trafiku nderkombetar tranzituar nga Albtelekom	16
Tabela 4 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2003-2008	16

I. HYRJE


AKEP, duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare dhe Albtelecom, ka perqatitur kete informacion mbi tregun celular dhe Albtelecom, nepermjet te cilit paraqitet ecuria treguesve kryesore statistikore qe permbledhin periudhen kohore 2003-2008. Ky raport eshte i pari ne serine e raportimeve mbi tregun, qe AKEP do te publikoje ne menyre periodike, dhe permban vetem tregun celular dhe Albtelecom, per shkak se te dhenat e sherbimeve te telefonise fikse te ofruara nga operatoret alternative te rrjeteve fikse nuk jane te plota. Me plotesimin e ketyre te dhenave AKEP do te publikoje nje dokument te vecante per sherbimet e telefonise fikse.

II. NUMRI I PERDORUESVE TE TELEFONISE CELULARE DHE FIKSE

Ne fund te vitit 2008 numri perdoruesve te telefonise se levizshme ariti ne **2 964 473** perdorues, e cila perben nje rritje te ndjeshme me **27.6 %** apo **642 mijë** perdorues me shume krahasuar me fund vitin 2007.


Operatori Eagle Mobile si operatori i ri celular qe hyri ne treg ne mars 2008, ka rritur ndjeshem numrin e perdoruesve, duke rezultuar me afersisht 260 mijë perdorues ne fund te vitit 2008. Megjithate, rritje ne krahasim me vitin 2007 kane patur edhe dy operatoret e tjere te telefonise se levizshme AMC dhe Vodafone, te cilet respektivisht kane nje rritje ne numrin e perdoruesve me 16.8% dhe 16.3%, apo me 200 dhe 183 mijë perdorues.

Figure .1 Perdoruesit e telefonise Mobile sipas operatoreve per 2003-2008





Numri i perdoruesve te telefonise fikse per Albtelekom ne fund te 2008 rezulton **263964** ose e shprehur ne % ka nje rritje kahasuar me fund vitin e 2007 me vetem **1.07 %**, apo **2818** perdorues me shume. Te dhenat per operatoret alternative nuk jane te plota, por sipas vleresimit rezultojne te jene rreth 60 000 pajtimtare. Ne baze te ketij vleresimi, numri i perdoruesve te telefonise fikse (Albtelekom + Operatoret Alternative) rezulton rreth 325 000.

Fig.2 Perdoruesit e telefonise fikse per Albtelekom dhe Op. Alternative 2003-2008



Referuar te dhenave te Instat per numrin e popullsise (projeksionet e REPOBA), si dhe te dhenave per tregun e telefonise se levizshme dhe asaj fikse 2003-2008, jane perllogaritur vlerat e penetrimit te telefonise se levizshme dhe telefonise fikse (numri i perdoruesve per 100 banore). Ne fund vitin 2008 penetrimi i telefonise se levizshme eshte **92 %**, kurse penetrimi i telefonise fikse eshte **10%**.

Grafiket qe ilustrojne numrin e perdoruesve si dhe penetrimin e telefonise fikse dhe mobile, paraqiten ne fig.3 dhe fig.4.

Fig.3 Perdorues te telefonise Mobile dhe Fiks 2003 - 2008**Fig.4 Penetrimi i telefonise Mobile dhe Fikse 2003 - 2008**


II.2 STRUKTURA E PERDORUESVE TE OPERATOREVE TE TELEFONISE FIKSE DHE MOBILE

a) Struktura e perdoruesve per Albtelekom

Për operatorin Albtelekom, struktura e perdoruesve eshte e ndare ne familjare, te tjere dhe telefona publike me pagese (PPP) dhe ne periudhen 2003-2008, vihet re nje rritje e vogel per secilin nga zerat e mesiperm, por duke kryhasuar ndryshimet ne kryhasim me 2007, atehere numri i përdoruesve te kategorise "familjare" ka nje rritje prej 0.9%, kategoria "te tjere" ka një rritje prej 3.2 %, kurse numri i



përdoruesve të kategorisë 'PPP' ka një rritje prej 0.6 %. Më poshtë paraqiten grafikisht përdoruesit e Operatorit Albtelecom në vite, për të gjitha grupet.

Fig.5 Perdoruesit sipas struktura te Albtelecom per 2003-2008



b) Struktura e perdoruesve per Operatoret Mobile

Struktura e perdoruesve celulare, te ndare ne perdorues me parapagim dhe me pas-pagim apo me kontrate eshte e ngashme per te tre operatoret, ku perdoruesit e telefonise celulare me parapagim vazhdojne te perbejne pjesen me te madhe te perdoruesve celulare ne nivele mbi 90%. Numri i perdoruesve me kontrate ka pasur rritje ne vite dhe kjo rritje ka vazhduar edhe ne vitin 2008, ku rritja eshte 34%, por shume me vogel se rritja e madhe me 88% ne vitin 2007. Nderkohe edhe perqindja e numrit te perdoreuve me kontrate ndaj numrit total te perdoruesve ka shenuar rritje ne vite dhe per vitin 2008 eshte shenuar një rritje e lehte ne raport me numrin total te perdoruesve, 6.47% ne krasasim me 6.18% ne vitin 2007. Ne vitin 2008, Vodafone ka patur rritje te % se perdoruesve me kontrate, ndersa AMC ka pasur ule te pjeses se ketyre perdoruesve ne raport me numrin e total te perdoruesve. Ne menyre grafike per te tre operatoret ne fig.6 dhe 7 paraqitet ecuria e numrit te perdoreuve me kontrate dhe parapagim dhe % qe zene numri i perdoruesve me kontrate ne raport me numrin total te perdoruesve, per periudhen 2003-2008.


Fig.6 Ecuria e numrit te perdoruesve dhe struktura e tyre 2003-2008**Fig.7 Perdoruesit me kontrate ne rapport me totalin e perdoruesve 2003-2008**

III. PERDORIMI I SHERBIMEVE TELEFONIKE CELULARE


III.1 Trafiku telefonik dhe SMS

Ne Fig.8 eshte pasqyruar trafiku telefonik i gjeneruar nga tre operatoret e rrjetave celulare i detajuar sipas destinacionit te thirrjeve: brenda rrjetit, drej rrjetete te tjera celulare, rrjete fiksese dhe nderkombetare. Vihet re se trafiku brenda rrjetit ka rritje te ndjeshme vjetore ne vitet 2007 dhe 2008. Ne vitin 2008 trafiku drejt rrjetit tjeter celular ka nje rritje ne 7% kurse trafiku dales nderkombetar dhe drejt rrjetete fiksese eshte pothuajse i njejte krasasuar me vitin 2007. Per vitin 2008 trafiku brenda rrjetit perben afersisht 70% te thirrjeve dalese dhe perben nje rritje te konsiderueshme ne krasasim me vitin 2006 ne te cilin ka qene ne nivel afersisht 50%.


Fig.8 Trafiku dales celular sipas destacioneve 2003-2008



Ne Fig.9 eshte pasqyruar trafiku telefonik hyres ne rrjetet e tre operatoreve celulare i detajuar sipas origjines se thirrjeve: brenda rrjetit, nga rrjetete te tjera celulare, rrjete fiksese dhe nderkombetare. Vihet re se perqindja qe ze trafiku brenda rrjetit ne trafikun hyres total ka rritje te ndjeshme vjetore ne vitet 2007 dhe 2008, duke zvogeluar peshen e trafikut nderkombetar hyres, i cili vazhdo te zeje peshen kryesore trafikun total hyres me afersisht 50%. Trafiku hyres nga rrjete fiksese eshte reduktuar gjate vitit 2008, ndersa trafiku nga rrjete celulare eshte rritur me ritme te ngashme me vitet e meparshem.

Fig.9 Trafiku hyres celular sipas origjines 2003-2008**Perdorimi i SMS sipas operatoreve Mobile per 2003-2008**

Numri i SMS te derguar nga abonentet celulare gjate vitit 2008 eshte 368 milion SMS, qe perben nje rritje me 19% ne krahasim me vitin 2007 (16% per Vodafone dhe 11% per AMC). Nderkohe numri i MMS eshte 1.42 milion, ku pjesen me te madhe eshte dergura nga perdoruesit e Vodafone (0.94 milion).

Fig.10 Numri i SMS-ve sipas operatoreve mobile ne 2003-2008

III.2 Pjeset e tregut te Operatoreve celulare

Ne tabelen e meposhtem paraqiten pjeset e tregut te tre operatoreve celulare per vitin 2008 per numrin e perdoruesve, thirrjet dalese dhe SMS. Vihet re EM ne 10 muaj aktivitetet bne treg ka perfituar pjesa tregu afersisht 9% per numrin e perdoruesve dhe 4% per thirrjet dhe SMS.

Tabela 1. Pjeset e tregut 2008

	Perdorues ne total	Parapagim	Kontrate	Thirrje dalese	SMS
AMC	47.09%	46.90%	50%	44%	31%
Vodafone Albania	44.21%	44.40%	41.30%	52%	64.50%
Eagle Mobile	8.70%	8.70%	8.70%	4%	4.50%

III.3. Perdorimi mesatar per perdorues i sherbimeve celulare



Ne vijim jane dhene tabela dhe grafike me te dhena per perdorimin mëjor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mëjor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga një perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga një perdorues), te matura ne minuta dhe numer thirrjesh. Keta tregues Jane llogaritur per te gjithe trafikun e gjeneruara dhe marre gjate vitit pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate vitit (mesatarja e numrit ne fund te vitit me fund vitin e meparshem). Minutat e perdorimit (Minutes of Usage-MOU) eshte shuma e thirrjeve dalese dhe hyrese, qe tregon se sa minuta ka shpenzuar një perdorues ne komunikim zanor. Perdorimi mëjor i SMS dhe MMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per te tre operatoret celulare.

Tabela 2. Perdorimi mesatar mëjor i sherbimeve celulare 2003-2008

	2004		2005		2006		2007		2008		
	AMC	VF-AL	EAGLE								
Thirrje dalese ne muaj											
	24.39	27.31	24.02	27.72	24.32	25.73	25.70	31.30	25.10	30.95	22.80
Thirrje hyrese ne muaj											
	51.05	51.58	49.11	51.68	46.29	49.20	46.28	52.09	45.88	50.39	22.38
MOU	75.44	78.89	73.12	79.39	70.60	74.92	71.99	83.39	70.97	81.34	45.17
SMS ne muaj	4.05	7.64	5.23	16.25	5.99	10.58	7.23	15.21	6.82	15.09	5.40
MMS/Muaj									0.03	0.06	0.00

Te dhenat variojne sipas operatoreve dhe rezulton se abonenetet e Vodafone kane perdorim me te madh: 31 minuta dalese dhe 50 minuta hyrese (81 minuta perdorim) ne muaj. Ndersa Eagle Mobile ka perdorim me te vogel: 23 minuta dalese dhe 22 minuta hyrese (45 minuta perdorim) ne muaj. Te dhenat tregojne se perdorimi mesatar mëjor eshte pothuajse ne te njejtat nivele si ne vitin 2007, madje me ulje te vogel.

Nderkohe te dhenat gjashtemujore tregojne se perdorimi me i madh I thirrjeve dalese eshte ne gjashtemujorin e dyte te vitit, dhe se perdoruesit e Vodafone kane një rritje te dukshme ne gjashtemujorin e dyte te vitit 2008 ne krahasim me te njejten periudhe ne vitin 2007, apo me gjashtemujorin e pare te vitit 2008. Nga grafiket e meposhtem mund te vihet re se ne gjashtemujorin e pare 2008 ka një reduktim te thirrjeve dalese, nderkohe qe ne gjashtemujorin e dyte ka një rritje te ndjeshme per Vodafone dhe rritje te vogel per AMC.

Fig.11 Thirrje dalese per perdorues te Vodafone 2003-2008**Fig.12 Thirrje dalese per perdorues te AMC 2003-2008**

Numri i Mesazheve SMS per perdorues per vitin 2008, nuk ka ndryshime nga viti 2007 por ka varianca te medha midis operatoreve: Perdoruesit e Vodafone dergojne mesatarisht 15 SMS ne muaj, ndersa te AMC dhe EM dergojne 7 dhe 5 SMS ne muaj.

Ne tabelen e meposhtme partaqiten kohezgjatja mesatare e thirrjeve celulare sipas destinacionit. Nga tabela vihet re se ka rritje te vogla te kohezgjatjes se thirrjeve jashte rrjetit (dhe brenda rrjetit per AMC) nderkohe qe thirrjet EM kane kohezgjatje me te madhe se thirrjet e perdoruesve te AMC dhe Vodafone, vecanersisht per thirrjet brenda rrjetit, 90 sekonda ndaj 48 apo 54 sekonda.

Tabela 3. Kohezgjatja mesatare e thirrjeve celulare

	2003		2004		2005		2006		2007		2008		
	AMC	VF-AL	EM										
Brenda rrjetit	35	27	35	37	34	37	39	38	42	56	48	54	90
Drejt Fiks	35	36	41	43	48	39	44	36	43	39	43	43	51
Mobile	27	27	34	35	35	35	36	36	38	38	39	39	47

III. PERDORIMI I SHERBIMEVE TELEFONIKE TE ALBTELECOM

IV.1 Trafiku telefonik i Albtelecom

Trafiku total i dales i perdoruesve te Albtelecom ka pesuar nje reduktim prej 8.5 % ne vitin 2008 ne krahasim me vitin 2007, reduktim me I vogel se ne vitin 2007 ku eshte vene re nje reduktim me 22%. Perseri pesha kryesore e ketij reduktimi vihet re te kete ardhur nga reduktimi i trafikut lokal. Trafiku telefonik lokal ka pasur luahatje te medha gjate viteve 2003-2008: ulje e ndjeshme ne vitin 2004 prej 39%, me rritje te konsiderueshme ne vitin 2005 dhe 2006 me 30% dhe 12% dhe ulje me 26 % ne vitin 2007 krahasuar me vitin 2006, si dhe serish nje ulje tjeter prej 7.7 ne 2008 krahasura me 2007. Trafiku ne destinacionet e tjera ka qene me luhatje me te vogla dhe i qendrueshem ne vite, me reduktime te vogla, pervec reduktimit me 13% te trafikut kombetar brenda rrjetit Albtelecom ne vitin 2008. Struktura dhe securia e trafikut dales te Albtelecom paraqitet ne fig 13 dhe 14.

Fig.13 Trafiku dales i Albtelecom per 2003-2008







Fig.14 Trafiku dales kombetar i Albtelecom per 2003-2008

Trafiku hyres ne Albtelekom per vitin 2008 ka pesuar rritje nga destinacioni nderkombetar krahasuar me 2007 me 32 %, nderkohe qe ka nje renie prej 18% te trafiku hyres nga operatoret alternative ne rrjetin e Albtelekom. Trafiku hyres nga operatoret celulare vazhdon te kete renie te vogel. Ilustrimi tabelar dhe ne menyre grafike per vitet 2003-2008 per trafikun hyres ne Albtelekom eshte ne fig.14.

Fig.14 Trafiku hyres i Albtelecom sipas origjines per 2003-2008

Trafiku telefonik ndërkombeṭar i tranzituar nga Albtelecom ka vijuar te reduktohet ndjeshem edhe ne vitin 2008 me 15%, reduktim me i vogel se ne reduktimi me 28% ne vitin 2007. Reduktimi i ndjeshem ka ardhur si pasoje e reduktimit te trafikut te tranzituar per operatoret celulare (hyres dhe dales nderkombetar).

Fig.15 Trafiku nderkombetar tranzituar nga Albtelekom



IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom

Ne taebelen 3, paraqiten disa tregues konsumi mujor te thieejve te perdoruesve te Albtelecom. Perdorimi eshte mature sipas trafikut total dalese dhe hyres (thirrje te marra perfshijne edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom,lokale dhe kombetare), pjestuar me numrin mesatar vjetor te perdorueve te Albtelecom. Reshti i fundit parqet totalin e minutave te komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga nje perdorues i Albtelecom, thirrje dalese dhe te marra. Nga tabela vihet re se konsumi i thirrjeve dalese eshte reduktuar ndjeshem ne vitin 2004 dhe 2007, ndersa ne vitin 2008 ka nje reduktim me 16 minuta apo 8%, reduktim i cili vjen nga reduktimi i thirrjeve lokale me 13 minuta ne muaj

Tabela 4 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2003-2008

	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thirrje dalese	296	187	227	239	180	164
Lokale dalese	256	154	193	206	149	136
Mobile	14	12	13	12	12	11
Kombetare drejt fiks	18	12	13	13	12	9
Nderkombetare	9	9	9	7	7	6
Thirrje te marra	314	207	242	255	205	191
MOU	610	394	469	493	386	355

Mesatarisht konsumi i thirrjeve te kryera eshte 164 minuta ne muaj dhe 191 minuta ne muaj thirrje te marra, qe do te thote qe nje perdorues i Albtelecom gjate vitit 2008 ka shpenzuar mesatarisht 355 minuta apo afersisht 6 ore ne komunikim me telefon fiks, prej ketyre 272 minuta apo afersisht 4.5 ore jane shpenzuar ne komunikim lokal.

Tirane, me 30.04.2009